

## VRESHTARIA DHE PRODHIMI I VERËS

Kultivimi i vreshtave është gjerësisht i përhapur dhe një burim i rëndësishëm i të ardhurave dhe vetëpunësimit për një numër të madh të fermerëve. Arrin mbi 300 mijë numri i fermerëve që kultivojnë rrushin në vreshta dhe pjergulla. Rrushi i pjergullave kultivohet kryesisht për përdorim familjar, i freskët, ose i përpunuar në formën e verës dhe pijeve alkoolike. Sipërfaqja e mbjellë me vreshta është rritur ndjeshëm vitet e fundit në mbi 11,040 ha dhe 6,545 rrënjë pjergulla, me një prodhim prej 211,178 ton dhe ndahet rreth 60% për verë/pije alkoolike dhe pjesa tjetër për tavolinë. Sipas statistikave të bujqësisë, rreth dy të tretat e fermerëve kultivojnë sipërfaqe deri në 0,2 ha. Zonat kryesore të prodhimit të rrushit gjenden mes kodrave dhe bregdetit të Shqipërisë. Fieri mbulon 19% të prodhimit me 2,069 ha, Elbasani 13% me rreth 1,406 ha, Vlora 12% me rreth 1,281 ha, Berati 11% me rreth 1,167 ha dhe Tirana 8% me 911 ha. Këto janë qarqet me përqindjen më të madhe të prodhimit duke dhënë më shumë se 60% të prodhimit vendas të rrushit. Shqipëria prodhon 211,178 ton rrush.



## KANTINAT E VERËS DHE PROBLEMATIKA E LËNDËS SË PARË

Nisur nga pozicioni gjeografik i favorshëm, kushtet atmosferike të përshtatshme, toka pjellore dhe varieteteve autoktone, Shqipëria ka një potencial të zhvillohet si një industri konkurruese në rajon dhe më gjerë. Që një kantinë të ketë rentabilitet duhet që minimumi të ketë 4-6 hektarë vreshta. Aktualisht në Shqipëri operojnë mbi 100 kantina vere.

Nga analiza e ekspertëve të NOA-s, si dhe vlerësimet e ekspertëve europianë që e kanë të zhvilluar këtë sektor, paraqitet një situatë e vështirë në prodhimtarinë e rrushit gjatë vitit 2023. Kushtet atmosferike, dhe rreshjet e shumta të shiut kanë ndikuar në dëmtimin e plantacioneve me vreshta (rreth 50%) si dhe në një rritje të kostove të prodhimit (shtim gati 3-fish të shërbimeve agroteknike). Kjo do ketë një ndikim shumë të madh në sigurimin e lëndës së parë për përpunim në kantina.

## “PLANIFIKONI SIGURIMIN E LËNDËS SË PARË NGA IMPORTI DHE NEVOJËN PËR KAPITAL QARKULLUES”

### “NOA FINANCON, NOA KËSHILLON”

Nga kalkulimet, mesatarisht një kantinë vere me kapacitetit të mesëm kërkon një sasi rrushi rreth 80-100 ton, pra blerje të lëndës së parë në një vlerë rreth 6–10 milion lekë, një nevojë për kapital qarkullues. Një nga synimet e NOA-s është të mbështesë të gjithë fermerët në bujqësi dhe agropërpunim që të zhvillojnë biznesin e tyre nëpërmjet financimit, këshillimit financiar dhe përthithjes së granteve në agrobiznes.

15 Korrik 2023

